



Misticizmi dhe etika në Islam

Description

Misticizmi dhe etika në Islam

Etika e Adud el-Din Ixhi

Feryal Salem

[Kjo ese është një përkthim i pjesshëm i manualit të mirënjohur të etikës islame “Ahlak El Adudije” shkruar nga dijetari i mirënjohur Adud el-Din el-Ixhi (vd. 1355). Manuali në fjalë përbën një nga tekstet rreth etikës Islame më me ndikim në periudhën post-klasike islame, veçanërisht në perandorinë osmane, por edhe më gjerë. Si i tillë teksti i manualit përfaqëson mendimin e mevonshëm Islam rreth etikës. Këtu kemi sjellë një parathënie kritike ndaj tekstit shkruar nga Feryal Salem e cila shoqërohet nga përkthimi i dy pjesëve të para të tekstit të manualit të el-Ixhit.

Në pjesën e parë, el-Ixhi shqyrton aspektin teorik dhe konceptual të etikës. Në të, ai shtjellon një seri virtyesh qendrore që burojnë nga tre dhuntitë bazë të vetes njerëzore, d.m.th. arsyetimi, zemërimi dhe dëshira. Virtytet e analizuar në këtë kontekst janë urtësia, kurajoja, maturia dhe drejtësia së bashku me nënkategoritë e virtyteve që rrjedhin prej tyre. Në pjesën e dytë, el-Ixhi analizon mënyrën se si ruhen dhe përftohen virtytet si edhe sëmundjet që burojnë prej fuqisë së dëshirës (shehue). Për secilin sëmundje autori ofron edhe një shpjegim të shkurtër të mënyrë se si mund të kurohen veset në fjalë.]

Parathënie kritike

Ebu el-Fadl Adudin Abdurrahman ibn Ahmed ibn Abdylgafar el-Ixhi (vd. 756/1355) lindi në qytetin e Ixhit në afërsi të Shirazit diku rreth vitit 680h/1281. I ati ishte jurist (kadi) i respektuar i cili thoshte se kishte prejardhjen nga kalifi i dytë mysliman, Ebu Bekri (vd. 13/634). Në vitet e tij ndërkohë që merrte formim, al-Ixhi udhëtoi për në Tabriz, ku ai kaloi njëfarë kohe duke studiuar gramatikë dhe shkencat racionale me Fahrudin Xharbardiun, i cili ishte student i dijetarit dhe ekzegjetit të mirënjohur Bejdeviu (vd. 685/1286). El-Ixhi studioi me Kutbedin el-Shirazin (vd. 711/1311), i cili ishte njëri nga studentët kryesor të Nasrudin el-Tusit (vd. 673/1274). Ka gjithashtu një të dhënë historike se në rini ai ka studiuar filozofi në kryeqytetin ilhanid të epokës së tij, të quajtur Sulltanije, nën patronazhin e vezirit Rashidudin (vd. 718/1318). Gjatë sundimit të Ulxhajtusë (1304-1316), el-Ixhi transmetohet se ka qenë edhe gjykatës në Sulltanije edhe mësues në medresetë shëtitëse që ishin bërë mbizotëruese në atë kohë.

Adudini eventualisht u bë njëri nga figurat më qendrore të asaj që mund të quhet epoka post-klasike (*mute'ahirin*) e mendimit islam pas Gazaliut (vd. 505/1111). Njëri prej dallimive të punës studimore të el-Ixhit është puna e tij në fushën e verifikimit apo "*tahkik*". Verifikimi ishte një formë e punës studimore në të cilën rishikoheshin tekstet e mëhershme islame dhe shkruheshin komentare për të vlerësuar nëse përmbajtja e veprave të mëhershme të teologjisë islame mund t'i mbijetonte shqyrtimit të argumenteve racionale të zhvilluara në fushën e filozofisë islame. Ndërkohë që el-Ixhi shkroi një numër tekstesh brenda një larmie fushash të asaj që mund të njihet si kurrikula hyrëse e teologjisë filozofike, heremeneutika ligjore, dhe gramatike (*usul el-din*, *usul el-fikh*, dhe *usul el-luga*) në kurrikulën e medreseve selxhuke dhe osmane, trashëgimia më jetëgjatë e el-Ixhit ka qenë teksti i tij mbi teologjinë islame, *el-Meuakif fi ilm el-kelam*. Dy studentët më të vlerësuar të el-Ixhit, Sejid Sherif el-Xhurxhani (vd. 816/1413) dhe Sadudin el-Taftazani (vd. 791/1390), të cilët kanë shkruajtur komentare të paçmuar mbi këtë veper, bënë të mundur që korniza e parashtruar në *Meuakif*-in e el-Ixhit do të bëhej themeltare për teologjinë sunite në shekujt në vijim.

Vepra e el-Ixhit "*el-Ahlak el-Adudiuje*" është ndër shkrimet e tij të tjera që nuk kanë qenë të njohura si kryevepra teologjike, e megjithatë kanë patur një ndikim domethënës mbi studimin e filozofisë morale në botën islame. *Ahlak el-Adudije* gjithashtu është anashkaluar në një masë të madhe në shkrimet akademike bashkëkohore dhe shpesh është eklipsuar nga vëmendje që i është kushtuar *Etikës Naseriane* mbi të cilën ajo është bazuar. Mustakim Arici pretendon se kjo indiferencë studimore mund të shpjegohet me fjalët e van Ess-it i cili i ka përshkruar veprat e shkurtuara të el-Ixhit se nuk përmbajnë asgjë që është e re në shkrimet e mërpashme, si në etikën e Tusit. Arici e sfidon këtë pikëpamje duke theksuar se në fakt është konciziteti i këtij traktati etik që e bën atë të dallueshëm. *Ahlak el-Adudije* ndjek një sekuencë të veprave që shqyrtonin etikën nga një perspektivë e etikës filozofike me rrënjë në *Etikën Nikomakeane* të Aristotelit. *Etika Nikomakeane* kishte një ndikim jetëgjatë mbi mendimtarë të shumtë myslimane, siç është el-Farabiu (vd. 339/950), Avicena (vd. 428/1037), Miskevejhi (vd. 412/1030), Nasrudin el-Tusi, el-Davaniu (vd. 908/1508), Adudin el-Ixhi, dhe studentët e tyre të shumtë të cilët veprën e Aristotelit e zhvilluan më tutje dhe e ripërkufizuan në terma islam ndërkohë që hartuan shumë interpretime dhe komentare të rinj.

Mustakim Arici shkruan se rëndësia e *Alak el-Adudije*-s shtrihet jo në përmbajtjen e traktatit, që ç'është e vërteta përmbledh veprën më të hollësishme të Tusit, por më saktë në formatin e saj. Forma e

përmbledhur e *Ahlak*-ut të el-Ixhit është ajo çka i dha kësaj vepre fleksibilitetin e saj për t'u adaptuar në rrjetet e medreseve ku ajo mund të memorizohej lehtësisht në një kohë kur tekstet e shkurtra në vargje (*mutun*) mësoheshin përmendësh dhe studioheshin me mësues që nuk mund të shkruanin komentare mbi to. Si rezultat i ristrukturimit nga ana e el-Ixhit të *Etikës Nasiriane* në një traktat, apo risale, të shkurtër, filozofia morale e el-Ixhit (dhe, si rrjedhojë, edhe ajo e Tusit) filloi të studiohej në një shkallë shumë më të gjerë.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i *Ahlak el-Adudije* është se ky tekst është i hartuar në arabisht, që e bënte atë të disponueshëm për një publik krejtësisht të ri studentësh për të cilët arabishtja ishte një gjuhë e njëjtë për mësimnxënien fetare. Vepra të ngjashme, si *Ahlak el-Nasiri* e Tusit apo *Ahlak el-Xhelali* e Davaniut, ishin shkruar fillimisht në persisht dhe vetëm më vonë ishin përkthyer në arabisht. *Ahlak el-Alai* e Kënalëzade Ali Efendi qe shkruar në turqisht. *Ahlak el-Adudije* është shkruar në arabisht dhe pothuajse të gjithë komentaret e saj janë po ashtu në arabisht, duke e bërë filozofinë morale islame një fushë të rrymës kryesore që studiohej nga studentët e mësimi fetar. Konciziteti i *Ahlak el-Adudije* lejonte që kjo vepër të interpretohej nga një larmi kornizash, sikurse do të shihet në shqyrtimin e shkurtër të komenteve në këtë studim.

Puna akademike e kohëve të fundit mbi etikën e el-Ixhit nisi në gjirin e akademikëve turq, të cilët kanë bërë një progres të gjerë në orientimin e vëmendjes drejt rëndësisë së *Ahlak el-Adudije*. Ky hulumtim i fokusuar i dekadës së fundit mori formën e tezave të ndryshme të masterit, dizertacioneve të doktoraturës, dhe një përpjekjeje të harmonizuar nga specialistë të ndryshëm ku secili ka hartuar botime kritike dhe përkthime në turqisht të të gjithë komenteve që njihen se jetojnë sot e kësaj dite. Specifikisht, Shoqata Turke e Dorëshkrimeve (Turkiye Yasma Eserler Kurumu) dhe Fondacioni i Studimeve Fetare (Ilmi Etudler Dernegi) nisën një projekt të përbashkët për të botuar të gjithë komentaret e *Ahlak*-ut të el-Ixhit në botime kritike në arabisht me përkthime në turqisht. Krahas kësaj, botimi i parë kritik i *Ahlak*-ut pa komentar u shfaq në një artikull të botuar nga Mustakim Arici në vitin 2009 dhe më vonë u shfaq sërish në një kapitull libri. Ky studim që keni në dorë bazohet mbi botimin kritik që Arici i ka bërë *Ahlak*-ut.

Lipsen përmendur veçanërisht studimet më të hershme akademike rreth *Ahlak el-Adudije* nga Elzem Içöz dhe Derya Topalcik, pasi të dy këta ka shkruar teza masteri në vitin 2007 ku kanë botuar dorëshkrime të harruara të komenteve të *Ahlak el-Adudije*. Puna kërkimore shtegshënuese Içöz dhe Topalcik në këtë fushë shtroi themelet për studimet e shumta që do të vinin më vonë. Teza e doktoraturës e Asiye Aykitmbi komentarin e Mynexhimbashë, ku ajo harton një botim kritik të veprës së tij të gjerë bashkë me një analizë të çmuar, është gjithashtu ndër studimet më domethënëse të komenteve të ndryshëm mbi etikën el-Ixhit. Mustakim Arici gjithashtu ka botuar gjerësisht si mbi *Ahlak el-Adudije* me fokus mbi komentarin e Taskëpyzadesë si edhe studime më të përgjithshme në fushën e filozofisë etike islame që shqyrtojnë aspekte të reja të ndryshme të kësaj fushe. Puna e gjerë kërkimore e Arici në filozofinë morale islame ka bërë që konsultimi i veprave të tij të jetë diçka e domosdoshme për studimin e mëtejshëm mbi këtë temë. Studiues të tjerë të cilët kanë kontribuar në këtë projekt të përbashkët mbi etikën e el-Ixhit janë: Ömer Türker, Mervenur Yilmaz, Selime Çinar, Kübra Bilgin Tiryaki, dhe të tjerë, sikurse kemi për ta parë. Ky studim vazhdon punën e tyre duke përkthyer *Ahlak el-Adudije* në anglisht ndërkohë që gjithashtu jep një pasqyrë të gjerë të komenteve të ndryshëm që janë shkruajtur mbi veprën e el-Ixhit.

Teksti i manualit

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Falenderimet i takojnë Zotit për mirësitë e Tij. Dhe paqja e mëshira qofshin mbi Pejgmaberin e Tij Muhamed dhe mbi familjen e tij. Le të vijojmë. Ky është një shkurtim i studimit të etikës që është ndarë në katër pjesë:

Pjesa e parë: Etika teorike (*el-Nazari*)

Karakteri është një prirje nga i cili veprimet manifestohen lehtësisht pa rrahje të mendimeve. [Besimi] në aftësinë e tij për të ndryshuar bazohet në përvojë, shpalljen e porosisë hyjnore lidhur me të, dhe konsensusin e [njerëzve] inteligjentë. Afiniteti për ndryshimin e tij varion bazuar mbi temperamentet e ndryshme (*amzije*).

Fakultetet (*kuv-ve*) e vetes (*nefs-it*) njerëzor janë tre.

[I pari është] arsyetimi (*el-nutk*). Forma e tij e moderuar është urtësia (*el-hikme*). Forma e tij e tepruar është mashtrimi (*xherbeze*). Mangësia e tij është budallallëku (*ghabaue*).

[Fakulteti i dytë i vetes njerëzore është] zemërimi (*el-ghadeb*). Moderimi i tij prodhon kurajon (*el-shuxha'a*). Teprimi i tij prodhon pamaturinë e kokëkrisur (*el-tahav-vur*). Dhe mangësia e tij është burracakëria (*el-xhubn*).

[Fakulteti i tretë i vetes njerëzore është] dëshira. Moderimi i saj është përmbajtja (*iffa*). Teprimi i saj është shthurja (*fuxhur*), dhe mangësia e saj është apatia (*xhumud*).

Virtytet janë [format] e moderuara të [secilit prej tre fakulteteve të renditura] dhe ato janë tre. Ekstremet e secilës prej këtyre formave janë veset dhe ato janë gjashtë.

Këto [tre virtyte] mund të jenë gjithashtu të korruptuara për shkak të mënyrës [në të cilën ato zbatohen]. Sa i përket [korruptimit të] urtësisë është shembulli i atij që mëson në mënyrë që të polemizojë me dijetarët dhe të debatojë me të marrët. Sa i përket kurajos, një shembull është ai që e tregon atë për të fituar famë dhe plaçkë. Sa i përket përmbajtjes, një shembull janë ata të cilët braktisin kënaqësitë, duke kërkuar më tepër prej tyre në amshim apo prestigj në këtë jetë. Këto janë virtyte në qoftë se nuk njollosen nga motive të mëtejshme dhe nëse manifestohen pa përpjekje për shkak se kjo (ndërthurje e virtyteve) është mirësi (*hajn*) dhe përsosmëri (*kemal*).

Mëpas, ka disa nënkategori për secilin virtyt.

Ka shtatë të tillë për urtësinë.

Ato janë: 1) Kthjelltësia e mendjes (*safa' el-dhihn*), që është aftësia e egos për të përshquar atë që është e dëshiruar pa pështjellim;

2) Përsosmëria në kuptim (*xheudet el-fehm*), që është aftësia për të arritur konkluzione të përpikta nga evidencat;

3) inteligjenca (*dheka*¹), që është shpejtësia në nxjerrjen e konkluzioneve;

4) Përsosmëria në konceptualizim (*husn el-tesav-vur*), që është aftësia për të figurizuar gjërat në përmasën e tyre të duhur;

5) Lehtësi në të mësuarit (*shulet el-ta'lim*), që është fuqia e egos për të rrokur idetë pa përpjekje të tepruar;

6) Kujtesa (*hifz*), që është aftësia për të ruajtur shëmbëlltyra të cilat janë kapur [nga mendja]; dhe

7) Sjellja në kujtesë (*el-dhukru*), që është aftësia për të kujtuar atë që është ruajtur [në mendje].

Kurajoja ka njëmbëdhjetë nënkategori.

Ato janë:

- 1) Shpirtmadhësia (*kibar el-nefs*), që është të shpërfillësh si rehatinë ashtu dhe varfërinë, madhështinë ashtu dhe parëndësinë;
- 2) Aspiratat e mëdha (*'izam el-himme*), që është një mungesë e preokupimit të tepruar me kënaqësitë e botës dhe vështirësitë e saj;
- 3) Durimi me këmbëngulje (*sabr*), që është kapaciteti për t'i bërë qëndresë dhimbjes dhe frikërave;
- 4) Të qenit sypatrembur (*nexhde*), që është të të mos kapë ankthi në kohëra frike;
- 5) Vetëpërmbytja (*hilm*), që është gjakftohtësia gjatë kohëve të zemërimit;
- 6) Ruajtja e qetësisë (*el-sukun*), që është ekuilibri gjatë zënkave dhe betejave;
- 7) Përunjësia (*teuedu*), që është përnderimi karshi atyre që kanë virtyt dhe të cilëve iu mungon pasuria dhe prestigji;
- 8) Vendosmëria (*shehame*) për të bërë detyra të jashtëzakonshme që përmenden si [vepra] të bukura;
- 9) Qëndresa (*el-ihtima*), që është ta durosh raskapitjen për hir të [të bërit] mirë;

10) Mbrojtja (*el-hamijje*), që është të zotërosh një sens të mbrojtjes kundër sulmeve ndaj të shenjtës dhe mbi fenë; dhe

11) Zemërbutësia (*el-rikka*), që do të thotë të përjetosh empati karshi dëmeve që pësojnë të tjerët.

Maturia (*el-'iffa*) ka njëmbëdhjetë nënkategori.

Ato janë:

1) Ndrojtja (*el-haja*), që është ta kufizosh veten si pasojë e frikës së të vepruarit të akteve të ulëta;

2) Durimi (*el-sabr*), që është ta përmbash veten nga të vepruarit në bazë të dëshirave;

3) Vetë-kontrolli (*el-da'a*), që është të mos tutesh kur të zgjohen dëshirat;

4) Integriteti (*el-nezaha*), që është të fituarit e pasurisë pa turpërim apo shtypje dhe ta shpenzosh atë për kauza të mira;

5) Të mbetesh i kënaqur (*el-kana'a*), që është të jesh i kënaqur me atë që është e mjaftueshme;

6) Dinjiteti (*el-uekar*), që rrjedhon prej të dhënit çështjeve të dëshiruara vëmendjen që i takon (pra, pa u ngutur);

7) Butësia (*el-rifk*), që është përsosmëria në angazhimin drejt qasaj që çon në atë që është e bukur;

8) Përsosmëria e përpjekjeve të tua (*husn el-semt*), që është dashuria për gjërat që do të kultivojnë përsosmërinë e egos;

9) Devotshmëria (*uera*), që është të kapesh fort pas akteve të bukura;

10) Dhënia e përparësive (*el-intizam*), që është t'u japësh vlerën e duhur çështjeve dhe t'i rendisë ato në përputhje me rezultatet e tyre të mira (*masalih*); dhe

11) Shpirtgjerësia (*el-sakha*), që është të japësh atë që është e përshtatshme për ata për të cilët është e përshtatshme.

Kjo (shpirtgjerësia) ka gjashtë nënndarje të tjera:

1. a) Bujaria (*el-kerem*), që është të japësh me lehtësi dhe në frymë të mirë;

1. b) Altruizmi (*ithar*), që është të heqësh dorë nga nevojat e tua [për t'i dhënë dikujt tjetër];

1. c) Shpirtmadhësia (*el-nubul*), që është të japësh me një zemër të lumtur;

ç) Të kesh dorë bujare (*el-muvasat*), që do të thotë të ndash [beteqetin, mirësitë e tua] me miqtë e tu;

1. d) Të shpenzosh lirisht (*semaha*), që është të shpenzosh më tepër [për të tjerët] kur nuk je i detyruar që të shpenzosh; dhe

1. dh) Shpirtbutësia (*musamehe*), që është të heqësh dorë nga gjërat për të cilat nuk ke nevojë, si pasojë e disiplinimit të vetes.

Drejësia është një term që i ndërthur të gjitha virtytet e tjera.

Nënkategoritë e saj janë

1) Miqësia e sinqertë (*?ad?ka*), që është të duash miqtë e tu me sinqeritet dhe motive të tjera dhe t'u duash atyre të mirën më tepër se sa vetes;

2) Pajtueshmëria (*el-ulfe*), që është përputhja e këndvështrimeve për të bashkëpunuar në administrimin e çështjeve dynjasore;

3) Besnikëria (*el-vefa*), që është të angazhohesh për përmbushjen e nevojave të të tjerëve që të mbash besën dhe premtimet që i ke dhënë aleatëve [miqve];

4) Kërkimi i afeksionit (*el-teueddud*), që është të kërkosh afeksionin e njerëzve të afërt nëpërmjet [veprave] që e shkaktojnë këtë;

5) Reciprociteti (*el-mukafa'a*), që është ta kthesh të mirën me të mirë apo me diçka edhe më të mirë se aq;

6) Përsosmëria në ortakëri (*husn el-sherike*), që është të jesh i ndershëm në ndërveprimet e tua;

7) Përsosmëri në kompensim (*husn el-kada*), që është t'i kompensosh të tjerët pa iu shkaktuar atyre brejtje të ndërgjegjsh apo pa i kujtuar atyre nderet që i ke bërë;

8) Ruajtja e lidhjeve të gjakut (*silat el-rahim*), që është ta drejtosh mirësinë drejt farefisit tënd;

9) Empatia (*el-shafaka*), që është të harxhosh energji për të hequr gjërat që nuk pëlqehen nga të tjerët;

10) Të zgjidhësh konfliktet (*el-islam*), që është të jesh një ndërmjetës midis njerëzve për të flakur tutje armiqësinë ndërmjet tyre;

11) Të mbështeturit tek Zoti (*el-teuekku*), që është të heqësh dorë nga të përpjekurit për gjëra që njerëzoria nuk ka kurrësi gjasa që t'i ndryshojë;

12) Nënshtrimi (*el-teslim*), që është të ndjekësh urdhërat e Zotit dhe të heqësh dorë nga objeksioni ndaj asaj që nuk të pëlqen;

13) të mbetesh i kënaqur (*el-rida*), që është të ruash qetësinë e shpirtit karshi gjëmave dhe humbjeve pa ndryshuar; dhe

14) Shërbestaria (*el-'ubudijje*), që është të tregosh përnderim ndaj Zotit dhe njerëzve të Tij dhe të ndjekësh porositë e tyre.

Pjesa e dytë: Ruajtja dhe të përftuarit e virtyteve

Cilido që arrin [të bëjë të vetin] një virtyt, qoftë nëpërmjet përfutimit të tij apo nëpërmjet natyrës së tij, duhet ta ruajë atë duke qëndruar afër me ata të cilët [zotërojnë virtyte të ngjashme] dhe duke shmangur shoqërinë e individëve të kalbëzuar. Ai duhet të tregohet i kujdesshëm që të mos i jepet dëfrimeve të tepruara, talljes, dhe polemikave apo grindjeve me fjalë. Ai duhet të merret me nxënien e dijes dhe me gjurmime intelektuale ndërkohë që mban parasysh kthjelltësinë, përhershmërinë, dhe dëlirësinë e atij virtyti si dhe degradimin e botës, përkohsmërinë dhe vështirësitë e saj. Ai duhet të përzgjedhë miq të sinqertë të cilët do t'i vënë atij në dukje të metat si edhe të shqyrtojë me kujdes fjalët që armiqët e tij thonë për të dhe të mësojë nga të metat e veta dhe t'i hedhë ato pas shpine. Ai [gjithashtu] duhet të ketë një sy çelë për gabimet e tjerëve në mënyrë që [të njëjtat gabime] t'i shmangë. Nëse ai pikas tek vetja një mangësi, ai duhet ta korrigojë atë me ushtrime të forta vetë-disiplinore. Cilido që ka bërë të vetën një ligështi [shpirtërore], ai duhet ta kundërgodasë atë [në rendin e mëposhtëm të avancimit duke filluar] me virtytin e saj të kundërt, me pas me ashpërsi, më pas vesin e saj të kundërt në mënyrë që ta shërojë veten [nga kjo ligështi shpirtërore] ndërkohë që duhet të jetë i

kujdesshëm që të mos kalojë në ekstremin e kundërt, dhe më pas duhet të kryejë ushtrime shpirtërore të mundimshme.

Ne do të rendisim këtu një pjesë të ligështive [shpirtërore] që shfaqen më shpesh, së bashku me kurat e tyre.

- Pështjellimi (*el-hajre*) shkaktohet nga të pasurit e evidencave kontradiktore, dhe kura e saj bëhet nëpërmjet jetësimit të parimeve intelektuale.

[Një tjetër ligështi e zakonshme shpirtërore është] injoranca e thjeshtë (*el-xhehl el-basit*). Ata të cilët e zotërojnë atë janë si bagëtitë për shkak se kanë humbur [cilësinë e dijes] që i dallon njerëzit nga kafshët. Në fakt, ata madje janë edhe më të humbur për shkak të [prirjes së bagëtive] për të kërkuar atë që është në interesin e tyre. Kjo ka si melhem të sajën të qëndruarit në shoqërinë e dijetarëve në mënyrë që mangësitë e tua të të bëhen ty të qarta nëpërmjet bashkëbisedimit me ta. Sa i përket injorancës së përbërë (*el-xhehl el-murekkeb*), në qoftë se dikush pranon një melhem, atëherë ndodh pikërisht nëpërmjet të punuarit me matematikë që ai shijon kënaqësitë e sigurisë, dhe më pas nëpërmjet të kushtuarit të vëmendjes ndaj arsytimit silogjik duke ndjekur [një proces të] avancimit.

- Sa i përket zemërimit (*el-gadeb, gazepi*), ai [shërohet] duke asgjësuar rrënjët e tij, që janë vaniteti dhe arroganca. Ato (vaniteti dhe arroganca) burojnë nga një individ që ka kaluar dy herë nga trakti urinar (ai i babait që çoi në konceptimin e tij dhe ai i nënës në lindje), dhe i cili do të vdesë nesër dhe do të ketë nevojë për sojin e tij [për t'u varrosur].[\[1\]](#)
- Epërsia (*el-iftikhar*) është madje edhe më tutje [se sa të dhënit rëndësi vetes] për shkak se ajo [rrjedh nga asocimi me] nderin e një personi tjetër. Përmasa e parëndësisë tënde realizohet nëpërmjet udhëtimit për në një vendndodhje në të cilën je krejtësisht i panjohur. Fama dhe konkurrenca (*el-mera' ue-l-xhah*) e prishin rendin [e shoqërive].
- [Sa i përket] talljes dhe përqeshjes (*el-mizah ue-l-istihza'*), ato jo vetëm që kanë dobi të pakët dhe ulin dinjitetin e një njeriu, por madje edhe ndjellin armiqësi dhe prishin rendin [shoqëror]. Cilido që është i paaftë ta përmbajë veten në përqeshje, ai duhet të heqë dorë prej saj [në tërësi].
- Mashtrimi dhe padrejtësia (*el-ghadr ue-l-dajm*) burojnë nga [dëshira] për kënaqësitë e kësaj bote [pavarësisht nga] parëndësia e tyre. [Për t'u shëruar], njeriu duhet të përfytyrojë, në mënyrë që të kuptojë ligësinë e saj, sikur kjo t'i bëhej atij nga të tjerët.

- [Një tjetër shkak për sëmundjet shpirtërore të mashtrimit dhe padrejtësisë] është të kërkojë të rivalizosh të tjerët me objekte materiale. Bashkë me mospëlqimin [e objekteve materiale], ato shumëfishojnë armiqtë e një njeriu. Në kohëra nevojë, njeriu zbulon se [këto objekte] nuk i bëjnë atij asnjë dobi. Madje edhe në qoftë se ato vazhdojnë të rrojnë për ty, ti nuk do të vazhdosh të rrosh [duke qëndruar i pavdekshëm për t'iu gëzuar] atyre.
- Sa i përket zemërimit, kur ai zgjohet, është e vështirë që të mbrosh mendjen nga zeznaja e tymit të tij, dhe gjithçka që vjen pranë kësaj zeznaje shërben si lëndë djegëse për të. Ndoshta ajo çka mund t'i bëjë dobij një njeriu në këtë rast është që të ndryshojë mjedisin, të pijë ujë të ftohtë, dhe të bjerë në gjumë. Zemërimi mund të jetë rezultat i një dëshire që nuk është plotësuar. Ai [zemërimi] mund të vlojë (*red'at kejfijjeten*) deri në atë pikë sa njeriu mallkon kafshët dhe objektet jofrymore. Të vëzhguarit e këtyre veprimeve dhe të zgjimit [të tërbimit] tek një person tjetër [të ndihmon] që ta drejtosh vëmendjen kah poshtërsia [e kësaj sjelljeje].
- Sa i përket burracakërisë (*el-xhubn*), ajo nxjerr në pah degradimin, mangësinë, dhe humbjen e respektit. Kura e saj shtrihet në ballfaqimin e frikërave të tua, marrjen përsipër të rreziqeve, dhe të sjellurit në kujtesë të pashmangshmërisë së vdekjes.
- Sa i përket frikës (*el-khauf*), [melhemi i saj është në] largimin prej shkaqeve të saj, nëse është e mundur; nëse jo, atëherë [melhemi është që] të adaptohesh ndaj saj.

Sëmundjet që burojnë prej fuqisë së dëshirës (*shehue*)

- Lakmia (*el-hirs*), [e cila mund të shërohet] nëpërmjet reflektimit se si ajo është e njëjtë me kafshët, [se si] kënaqësitë [materiale] janë të kota dhe jetëshkurtra, si edhe nëpërmjet [reflektimit] se sa të urryera janë gjërat që kërkojnë. [Krahas kësaj, njeriu mund ta gjejë melhemin në] të konsideruarit e urtësisë që fshihet në praninë e fakultetit të dëshirës, dhe në zotërimin e një mendjeje të shëndoshë gjatë [kohëve të] ngasjes për egon (nëfsin) si edhe të preokupuarit me të mësuarit dhe çështje të tjera që ia largojnë mendjen njeriut [nga joshjet] dhe duke shmangur atë që do të shkaktojë kaplimin prej tyre.
- Dembelizmi (*el-batale*) [është një tjetër ligështi shpirtërore e rrënjësuar në dëshirë dhe] çon në shkatërrimin e egos dhe trupit dhe i përngjan paralizës në terma të paaftësisë dhe humbjes së urtësisë. [Mund të shërohet] nëpërmjet mbajtjes së shoqërisë me njerëz që janë të mbrujtur me

motivim dhe duke reflektuar mbi frytet e mundimeve të tyre si edhe nëpërmjet të dëgjuarit të historive të tyre [të suksesit] dhe poshtërimit që i ka ndodhur individëve përtacë dhe rezultatet e tyre të pafavorshme.

- Trishtimi (*el-huzn*) buron nga të besuarit se gjitha dëshirat e tua do të përmbushen se kjo gjë do të vazhdojë. Kjo është injorancë. Njeriu duhet ta drejtojë [vëmendjen kah] veprat e mira që kanë [mirëfilltazi e çiltërsisht] përhershmeri.
- Zilia [hasedi, *el-hased*] buron nga injoranca dhe lakmia që vjen nga të mos diturit se një person i vetëm nuk mund të ketë gjithçka që është e mirë. Rezultati i saj është trishtimi i pandërprerë, dhe [forma] e saj më e përçmuar [është kur ajo manifestohet në gjirin e] dijetarëve [fetarë]. Në qoftë se njëri prej tyre (dijetarëve) është fatlum, kjo nuk është shkak që një tjetër (dijetar) të ketë privime.
- Dëshira e zjarrtë (*el-ghibta*) është të dëshirosh që të shtiesh në dorë të mira pa dëshiruar që të njëjtat të mira të humben nga dikush tjetër. Ajo është e lëvdueshme në punët e fesë dhe është një formë lakmie (*hirs*) në punët e dynjasë.
- Koprracia (*el-tama'*) është një [gjendje] e ulët që vjen nga [gërshetimi] i lakmisë, dembelizmit, dhe injorancës lidhur me urtësinë e Zotit të Lartësuar në [krijimin e] nevojës për bashkëpunim.
- Pakënaqësia ndaj dikujt (*el-hikd*) shërohet duke imagjinuar vëllazërinë e vërtetë [me personin ndaj të cilit ke pakënaqësi]. Të gënjerit (*el-kedhib*) është më keq se të mos flasësh për shkak të shprehjes së ideve që nuk janë të vërtetë dhe ka të ngjarë që ajo të nxisë dëmin.
- [Për të shëruar këtë ligështi shpirtërore] njeriu duhet të reflektojë mbi poshtërsinë që të gënjerit nxit edhe dyshimin dhe humbjen e respektit [që rezulton nga të gënjerit]. Prej tij [të gënjerit] dhe prej admirimit për veten (*el-'uxhb*) burojnë mburrja (*el-salef*) dhe hipokrizia (*el-nifak*).

Përktheu: Arjol Guni

[1] Ky është një aludim për Kuran 77:20-26.

Date Created

11/02/2022

Author

erasmusi